



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN 669 TË DATËS 28.05.2019 PËR MIRATIMIN E
VËZHguesve AFATGJATË TË KOMITETIT SHQIPTAR TË HELSINKIT NË
ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS

30 QERSHOR, 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 12.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për një shtesë në vendimin 669 të datës 28.05.2019 për miratimin e vëzhguesve afatgjatë nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 6, pika 2, 4, 5, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr.13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave"

V Ë R E N

Komiteti Shqiptar i Helsinkit është organizatë jo qeveritare e specializuar dhe angazhuar, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe me përvojë në vëzhgimin e proceseve zgjedhore. Misioni i KShH-së është të kontribuojë për respektimin e të drejtave të njeriut, forcimin e shtetit ligjor, si dhe zhvillimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme, në



Nr. 834 i Vendimit

Data 12 .06.2019

Ora 13.⁰⁰ e Vendimit

Për një shtesë në vendimin 669 për miratimin e vëzhguesve afatgjatë të KSHH për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor,

2019

përputhje me Kushtetutën, aktet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Kjo organizatë ka paraqitur kërkesën e saj bashkë me dokumentacionin mbështetës pranë KQZ për akreditimin e 17 (shtatëmbëdhjetë) vëzhguesve afatgjatë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vëren se ai është brenda kushteve dhe kërkesave të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", neni 6, pika 2, 4, 5 të ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e KSHH, për akreditimin e 17 (shtatëmbëdhjetë) vëzhguesve afatgjatë për vëzhgimin e procesit zgjedhor për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor 2019, sipas listës të përcaktuar në lidhjen Nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare



Nr. 834 i Vendimit Data 12 .06.2019 Ora 13.⁰⁰ e Vendimit

Për një shtesë në vendimin 669 për miratimin e vëzhguesve afatgjatë të KSHH për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor, 2019